



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural  
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja  
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

---

**DEKLARATË E PERPUTSHMERISE SË LEGJISLACIONIT TË REPUBLIKËS SË  
KOSOVËS ME ACQUIS TË BE-së**

**1. Organi propozues i aktit normativ:**

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

**2. Titulli i projekt aktit normativ:**

Projekt Ligji për Ratifikimin e Marrëveshjes në mes Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Deutsche Gesellschaft für Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, për Projektin Mbështetja për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Sektorit të Bujqësisë në Zonat Rurale përmes diversifikimit të aktiviteteve.

**3. Përputhshmëria e aktit normativ me dispozitat e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ose Marrëveshjes së Përkohshme:** Neni 102 i MSA-së (Bujqësia dhe sektori agro-industrial) përmes të cilit përcaktohet se palët do të bashkëpunojnë në fushat me prioritet që kanë të bëjnë me fushën e bujqësisë, skemat e cilësisë për produkte bujqësore, dhe ndër të tjera përcakton se do të kryhet plotësisht përafrimi gradual i legjislacionit dhe praktikave të Kosovës me acquis të BE-së.

**3.1 Dispozitat e MSA-së dhe Marrëveshjes së Përkohshme në lidhje me përmbajtjen normative të aktit normativ:** Neni 74 i MSA-së përcakton se palët e kuptojnë dhe zotohen për përafrim të legjislacionit ekzistues të Kosovës me atë të BE-së dhe të zbatimit të tij efektiv.

**3.2 Afati kohor i përcaktuar për përafrimin dhe harmonizimin e legjislacionit në përputhje me dispozitat e MSA-së dhe Marrëveshjes së Përkohshme:** Neni 9 i MSA-s përcakton se Asociimi në mënyrë progresive dhe të plotë do të realizohet gjatë një periudhe prej dhjetë vitesh.

3.3 Vlerësimi i nivelit të përmbushjes së detyrimit /obligimit që rrjedh nga dispozitat e lartpërmendura të MSA-së dhe Marrëveshjes së Përkohshme: Dispozitat e Ligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes në mes Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Deutsche Gesellschaft für Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, për Projektin Mbështetja për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Sektorit të Bujqësisë në Zonat Rurale përmes diversifikimit të aktiviteteve për nga niveli i përmbushjes së dispozitave të MSA-së mund të cilësohet si i plotë, për arsye se rregullon këtë fushë e cila deri më tani në Kosovë dhe në legjislacionin e Kosovës nuk ka qenë e rregulluar.

#### 4. Përputhshmëria e legjislacionit me Acquis e BE-së.

##### 4.1 Lista e burimeve sekondare të së drejtës të BE-së dhe përputhshmëria me to:

4.1.1. Marrëveshjen ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për Bashkëpunim Teknik të datës 12 shtator 2018,

4.1.2. Të dhënat përmbledhëse të negociatave për bashkëpunim zhvillimor ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë të mbajtur virtualisht më 8 dhjetor 2020 si dhe duke marrë në konsideratë;

4.1.3. Marrëveshjen Implementuese ndërmjet Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH / Projekti: Zhvillimi ekonomik për stabilizimin e tregut të punës (Promovimi i Ndërmarrësisë) dhe Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) e datës 27.07.2022.

4.1.4. Ligji Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare (Gazeta Zyrtare Nr.28/16.12.2011).

##### 4.2. Lista e burimeve tjera të së drejtës të BE dhe përputhshmëria me to:

Nuk zbatohet.

##### 4.3 Periudha kohore brenda së cilës është e paraparë realizimi i plotë i përputhshmërisë të legjislacionit me Acquis e BE.

Dispozitat e Ligji për Ratifikimin e Marrëveshjes në mes të Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Deutsche Gesellschaft für Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, për Projektin Mbështetja për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Sektorit të Bujqësisë në Zonat Rurale përmes diversifikimit të aktiviteteve për nga niveli i përmbushjes së dispozitave të MSA-së mund të cilësohet si i plotë, për arsye se rregullon këtë fushë e cila deri më tani në Kosovë dhe në legjislacionin e Kosovës nuk ka qenë e rregulluar. Afati është në përputhje me Nenin 9 të MSA-së, periudha kohore 2023-2027.

5. Të specifikohet kur nuk ka legjislacion të BE-së me të cilën përputhshmëria është e kërkuar. (Në këtë rast, nuk është e domosdoshme të plotësoni tabelën e përputhshmërisë së legjislacionit).

Nuk zbatohet.


**6. Pjesëmarrja e konsulentëve në hartimin e akteve normative dhe mendimin e tyre për përputhshmërinë (të bashkangjitur shkresat e konsulentëve për hartimin e akteve normative).**

Ka qenë i përfshirë ekipi negocues nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Zyra e Kryeministrit, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe GIZ-it, të cilët kanë propozuar disa ndryshime në tekstin e Projektligjit.

**7. Nënshkrimi i Udhëheqësit të Departamentit Ligjor të organit shtetëror, ose propozuesit tjetër të aktit normativ.**

Isah Rudaku,


Zv. Drejtor i Departamentit Ligjor



**8. Nënshkrimi i Ministrit apo udhëheqësit të organit shtetëror, ose propozuesit tjetër të aktit normativ.**

Faton Peci,

Ministër i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural



Data: 03.04.2023